

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Prodhim , transport, shkurtrim-çarje dhe magazinim pranë institucionit në varësi të bashkisë Tropojë të sasisë prej 1363m³ (2276 mst) dru zjarri”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT CPV-03412000-1

VLERA E FONDIT LIMIT:

4561733 Lek pa TVSH. (kater milion e peseqind e gjashtedhete e nje mije e shtateqind e tridhete e tre).

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor Bashkia Tropoje ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Operatoret ekonomik pjesëmarrës në këtë prokurim duhet që të plotësojnë kapacitet ligjore, teknike dhe profesionale për kryerjen e këtij prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika l/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

(Shënim: përcaktoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë dy viteve fundit financiare (2020- 2021) lëshuar nga autoritetet përkatëse, ku vlera e xhiros minimale për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit të parashikuar të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

-Duke marrë në konsideratë specifikën e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohej që OE Ofertues të paraqes OE se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik sipas Përcaktimit të viteve të kërkuara për përgaditjen e vertetimit të xhiros vjetore bazuar në dispozitat e legjislationit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", I ndryshuar, Udhezimit të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", I ndryshuar. VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjerata tatimore, vetëm nëpërmjet të formës elektronike".

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

2.2.2. Kopje e vertetuar te bilanceve te dy viteve të njëpasnjëshme 2020-2021 , nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit .

Argumentimi:-Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar:

Duke marrë në konsideratë specifikën e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqet se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik sipas Përcaktimit të viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore bazuar në dispozitat e legjislacionit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", I ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", I ndryshuar. VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjerata tatimore, vetëm nëpërmjet mjeteve të formës elektronike".

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertët kontabël ose shoqëritë audituese).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

- a) Autoriteti Kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, kontrata furnizimi ose/dhe fatura

tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe në nenin 55, pika 4/b (*Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës*”, e VKM nr 285, date 19.05.2021, ku përcaktohet Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjilacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohej, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Shënim: Autoriteti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:

3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

3.1. Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet e nevojshme për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin dëshmi për të pakten 2 (dy) automjete (pronësi ose me qera), automjet transporti mbi 5 ton.

Për të dëshmuar këtë, operatorët ekonomike duhet të paraqesin dokumentat e mëposhtme:

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publike, nëse janë në pronësi, duhet të paraqiten dokumenta që vërtetojnë regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikata e kontrollit teknik, policia e sigurimit vjetor.

b) Për mjetet që shënohen në regjistrat publik, nëse janë me qera, duhet të paraqiten dokumenta që vërtetojnë regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikata e kontrollit teknik, policia e sigurimit vjetor, si dhe kontrata perkatëse e qerave.

-të jenë te pajisur me leje drejtimi te kategorise perkatese te mjeteve te mesiperme

2. Operatori Ekonomik duhet te zoteroje dhe te paraqese nje çertifikate ISO 9001-2015 te vlefshme ose ekuivalente per sistem menaxherial te cilesise, ose ekuivalente me te.

Argumentimi: Kërkesa në lidhje me këto çertifikata është në përputhje me nenin 44, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", dhe nenin 79, të Nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" si dhe në lidhje me licensën profesionale është mbështetur në nenin 40 pika 5/ç i VKM nr.285 , datë 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”.

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).